



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77/16 gusht 2010) dhe nenet 46 dhe 85 të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2016, miratoi si vijon:

## **RREGULLORE PËR EKSPOZIMET E MËDHA**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të parandalojë koncentrimet e rrezikut kreditor të mjeteve të rrezikuara në portofolin e një banke duke imponuar kufizime në ekspozimet kreditore dhe për të siguruar që ekspozimet e mëdha trajtohen ndryshe nga ekspozimet e tjera.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në vijim: BQK) për të operuar në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare (në vijim: *Ligji për bankat*) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllim të kësaj rregulloreje:

*1.1. Bankë* - një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur.

*1.2 Degë e bankës së huaj* - një person juridik që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licencë për t'u angazhuar në veprimtari bankare në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës e cila është e licencuar nga BQK për të operuar si degë e bankës së huaj në Republikën e Kosovës.

*1.3. Ekspozim* – është çdo aktivë ose zë jashtë-bilancor i gjendjes, duke përfshirë pa kufizim ndonjë kredi apo zotim direkt ose indirekt për pagim të parasë në shkëmbim të së drejtës për kthim të shumës së paguar dhe të mbetur dhe për pagesën e interesit apo, shpenzimeve të tjera që lidhen me këtë shumë, çdo shtyrje të datës së pagimit të borxhit, çdo garancion apo letër-kredi të lëshuar, letra me vlerë të borxheve dhe forma të ngjashme të kreditimeve apo zotimeve për kreditime të dhëna nga banka për klientin, si dhe aksionet, pjesëmarrjen në kapital dhe llojet e tjera të investimeve në një person juridik nga banka.

1.4. *Ekspozim i madh* - çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm apo grupi të personave të ndërlidhurqë tejkalon përqindjen e kapitalit të klasit 1 të specifikuar nga BQK-ja në nenin 46 të Ligjit për Bankat . Për degët e bankave të huaja ekspozim i madh definohet çdo ekspozim ndaj një huamarrësi të vetëm apo grupi të huamarrësve të ndërlidhur, nëse shuma e të gjitha ekspozimeve e tejkalon dhjetë për qind (10%) të kapitalit të klasit të I-rë të bankës mëmë.

1.5 *Kontroll* - raporti kur një person apo grup personash, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi: (i) posedon shumicën e aksioneve të personit juridik; (ii) ka kompetencë për të emëruar apo larguar shumicën e bordit të drejtorëve të personit juridik; apo (iii) ka mundësi për të ushtruar ndikim të konsiderueshëm në menaxhimin apo politikat e personit juridik;

1.6 *Grupi i personave të ndërlidhur* - nënkupton dy apo më tepër persona (fizik, juridik apo të dyja) të cilët janë të ndërlidhur, direkt apo indirekt, në atë mënyrë që qëndrueshmëria financiare e cilitdo prej tyre mund të ndikojë në qëndrueshmërinë financiare të ndonjërit apo të gjithëve; apo nëse si rezultat i strukturës së marrëdhënieve të tyre, faktikisht personi tjetër është përfundimisht përgjegjës për shumën e kredisë aktive. Në veçanti, personat individual të bankës konsiderohen si grup i personave të ndërlidhur, në rastet kur:

- a) Burimi i pritshëm i ripagesës për secilën kredi është i njëjtë për secilin huamarrës dhe asnjëri person / huamarrës nuk ka burim tjetër të të hyrave prej të cilave kredia (së bashku me obligimet tjera të huamarrësit) mund të paguhen plotësisht.
- b) Kreditë u janë lejuar huamarrësve, të cilët janë të ndërlidhur direkt apo indirekt përmes kontrollit të zakonshëm, përfshirë edhe kur një person direkt apo indirekt kontrollohet nga huamarrësi tjetër.
- c) Ekziston ndërvarësi e konsiderueshme financiare ndërmjet huamarrësve: ndërvarësi e konsiderueshme financiare konsiderohet të jetë kur pesëdhjetë përqind (50%) apo më shumë të arkëtimeve bruto të një huamarrësi ose të pagesave bruto (në bazë vjetore) rrjedhin nga transaksionet me huamarrësin tjetër. Arkëtimet bruto dhe pagesat përfshijnë bruto të hyrat/shpenzimet, kreditë ndërmjet kompanive, kontributet në kapital, dhe arkëtime apo pagesa të ngjashme.
- d) Huamarrësit e ndarë, marrin hua nga një bankë për të blerë një ndërmarrje tregtare (biznesore), prej të cilave këta huamarrës do të zotërojnë më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të aksioneve me të drejtë vote .
- e) Në raste të tjera kur BQK-ja përcakton, në bazë të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të transaksioneve të veçanta, që qëndrueshmëria financiare e cilit do huamarrësi mund të ndikojë në qëndrueshmërinë financiare të tjetrit.
- f) Sipas gjykimit të arsyeshëm të BQK-së, një ndërmarrje e përbashkët në mënyrë të qartë ekziston ndërmjet personave.

### **Neni 3**

#### **Kufizimet e ekspozimeve**

1. Asnjë bankë nuk do të lejojë një ekspozim ndaj çdo personi apo grupi të personave të ndërlidhur që tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të I-rë ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren e BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, përveç nëse ekspozimet e tilla fillimisht janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të bankës në mbledhjet e mbajtura sipas përcaktimeve të nenit 27 të Ligjit për Banka..

2. Në rastin e degës së bankës së huaj nuk do të lejohet asnjë ekspozim të çdo personi apo grupi të personave të ndërlidhur që tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të I-rë të bankës mëmë, të përcaktuar sipas kërkesave të rregullatorit në vendin ku është themeluar banka e huaj, përveç kur ekspozimet e tilla fillimisht janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të bankës mëmë.

3. Asnjë banke nuk i lejohet të ketë ekspozim ndaj një personi të vetëm ose një grupi të personave të ndërlidhur, nëse si rezultat i këtij veprimi, ekspozimi ndaj atij huamarrësi apo grupi e tejkalon pesëmbëdhjetë përqind (15%) të kapitalit të klasit të I-rë. Në rastin e degës së bankës së huaj ekspozimi sipas këtij paragrafi duhet të jetë pesëmbëdhjetë përqind (15%) në raport me kapitalin e klasit të I-rë të bankës mëmë. Pavarësisht nga kjo, ekspozimi ndaj një personi ose një grupi të personave të ndërlidhur në rastin e degës së bankës së huaj, asnjëherë nuk duhet të tejkaloj shumën prej njëzetepesë milion eurove (25,000,000). Limiti i përcaktuar prej njëzetepesë milion eurove (25,000,000) do të jetë subjekt i rishikimit varësisht nga zhvillimet e tregut.

4. Për qëllim të paragrafit 2 të nenit 46 të Ligjit për banka, kufizimi prej treqind përqind (300%) të kapitalit të klasit I-rë për ekspozimet e mëdha të grumbulluara kreditorë, do të zbatohet për të gjitha ekspozimet ndaj personit apo grupeve të personave të ndërlidhur, kur secili nga ata e tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të I-rë të bankës. Në rastin e degës së bankës së huaj ekspozimi sipas këtij paragrafi duhet të jetë në raport me kapitalin e klasit të I-rë të bankës mëmë.

5. Të gjitha aprovimet e ekspozimeve të mëdha sipas këtij neni duhet të dokumentohen në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve. Në rastin e degëve të bankave të huaja, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve të bankës mëmë lidhur me aprovimet e ekspozimeve të mëdha të degës në Kosovë, duhet të ruhen edhe në degën e bankës së huaj në Kosovë.

### **Neni 4**

#### **Konsolidimi**

1. Nëse një bankë është anëtare e një grupi bankar, subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar në përputhje me dispozitat e Rregullores së BQK-së për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare, kufizimet nga neni 46 i Ligjit për banka dhe kjo Rregullore, do të zbatohen duke iu shtuar së bashku të gjitha ekspozimet palës tjetër të njëjtë nga të gjithë anëtarët e grupit dhe në lidhje me ekspozimin total ndaj kapitalit rregullator të grupit.

## **Neni 5**

### **Përfashtimet**

1. Bankat dhe degët e bankave të huaja mund të përjashtojnë tërësisht nga kufizimet e përcaktuara me paragrafin 3 dhe 4 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, kategoritë e mëposhtme të ekspozimeve:
  - 1.1. Pjesët e ekspozimeve të mbuluara me para të gatshme në Euro ose valuta të tjera lehtësisht të konvertueshme, vlera e të cilave gjatë gjithë kohës duhet të jetë më së paku njëqind përqind (100%) të ekspozimit aktiv, këto para të gatshme duhet të jenë në bankë në çdo kohë apo të plasuar në bankë në llogari të veçantë të pengut apo të bllokuara, të emërtuara dhe evidentuara qartë me marrëveshje të plotfuqishme sigurie.
  - 1.2. Ekspozimet në formën e letrave me vlerë të borxhit, të emetuara ose të garantuara pa kushte nga Qeveria e Republika e Kosovës ose nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore të vendeve të cilat janë të klasifikuara së paku me kapacitet të fuqishëm pagese, siç është definuar në aneksin 1 të Rregullores së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave apo pjesët e ekspozimeve kreditore të mbuluara me letrat me vlerë të borxhit, margjinat e të cilave gjatë gjithë kohës duhet të mbahen më së paku njëqind e njëzet e pesë përqind (125%) të shumës aktive, sipas vlerës së tregut, ku këto letra me vlerë do të dorëzohen në bankë në formë të regjistrimit në libra, e kënaqshme për BQK-në apo në formë certifikate, aktualisht e dorëzuar dhe e lënë peng me marrëveshje të plotfuqishme sigurie.
  - 1.3. Pjesët e ekspozimeve të mbuluara nga instrumentet e tregut të parasë të lëshuara në tregjet e parasë së Evropës apo Amerikës Veriore sikurse janë: letër-pranimet (banker's acceptances) të lëshuara nga bankierët primar të cilat janë të vlerësuara së paku me kualitet të lartë kreditor siç është definuar në aneksin 1 të Rregullores së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, certifikatat e depozitave dhe letrat komerciale të emetuara nga bankierët primar të cilat janë të vlerësuara së paku me kualitet të lartë kreditor siç është definuar në aneksin 1 të Rregullores së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, dhe instrumentet tjera që BQK-ja do t'i aprovojë rast pas rasti. Ekspozimet e mbuluara sipas kërkesave të këtij paragrafi duhet të kenë margjina të mirëmbajtura në çdo kohë, sipas vlerave të tregut, prej më së paku njëqind e tridhjetë përqind (130%) të shumës së papaguar, ku të gjitha instrumentet e tilla duhet të jenë të dorëzuara dhe të lëna peng me marrëveshje të detyrueshme.
  - 1.4. Ekspozimet në rastet e transfereve të parave që përfshijnë ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjeve në valuta të ndryshme, dhe ekspozimet tjera që rrjedhin nga aktivitetet me bankat korresponduese, të cilat realizohen brenda ditës së punës ose në rast kur transaksionet e tilla janë në proces i cili nuk zgjat me shumë se deri ditën e nesërme të punës. Këto ekspozime përjashtohen edhe nga kufizimet për transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën.
  - 1.5. Ekspozimet në rastin e transaksioneve për qëllimin e këmbimeve valutore të cilat ndodhin përgjatë kursit të rregullt të shlyerjeve brenda dy ditë pune pas pagesës. Këto ekspozime janë të përjashtuar edhe për qëllimin e kufizimeve për transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën.

- 1.6. Shuma e depozitave me afat maturimi prej një viti apo më pak në institucionet financiare të cilat janë të klasifikuara së paku me kapacitet të fuqishëm pagese siç është definuar në aneksin 1 të Rregullores së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, të cilat janë të siguruara në tërësi nga skema e sigurimit të depozitave.
2. BQK-ja në rastin e bankave mund të lejoj përjashtim nga kufizimet prej pesëmbëdhjetë përqind (15%) deri në maksimum njëzet e pesë përqind (25%) të kapitalit të klasit të I-rë, për kategoritë e mëposhtme të ekspozimeve kreditore siç janë paraparë me Ligjin për bankat:
  - 2.1 Ekspozimi kreditor i cili plotësisht është i siguar nga kolaterali i gatshëm për tregtim. Për qëllime të këtij nën-paragrafi, me termin kolateral i gatshëm për tregtim nënkupton vlerën e tregut të kolateralit në formë të hipotekës së rendit të parë të diskontuar nga banka (përjashtuar kolateralin në formë të pengut) në momentin e lejimit të kredisë, e cila mbulon ekspozimin kreditor së paku njëqind përqind (100%). Kjo pronë duhet të jetë e vlerësuar nga vlerësues të licencuar të pronave, në pajtim me kërkesat e Rregullores për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
  - 2.2 Ekspozimet ndaj apo pjesa e ekspozimeve e garantuar nga bankat të cilat janë të klasifikuara së paku me kapacitet të fuqishëm pagese, siç është definuar në aneksin 1 të Rregullores së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit dhe që kanë afat maturimi prej një viti ose më pak.
3. Kufizimet e përcaktuara me nenin 3 të kësaj rregulloreje, për rastet e ekspozimeve jashtëbilancore në vijim, bankat dhe degët e bankave të huaja, duhet të aplikojnë pesëdhjetë përqind (50%) të ekspozimit:
  - 3.1. Pjesët e pashfrytëzuara të zotimeve me afat maturimi bazë prej 1 (një) viti ose më pak dhe pjesët e pashfrytëzuara të zotimeve të cilat janë pa kushte të anulueshme në çdo kohë, pa marrë parasysh afatin dhe të cilave i caktohet zero përqind (0%) e vlerës së tyre nominale me qëllim të matjes së rrezikut.
  - 3.2. Letër kreditë vetë-likuiduese afatshkurta të lidhura me tregti; duke përfshirë letrat komerciale të kredisë dhe garancioneve për tender, të cilave i caktohet njëzet përqind (20%) të vlerës së tyre nominale me qëllim të matjes së rrezikut.
4. Pavarësisht nga përcaktimet e këtij neni, BQK-ja rezervon të drejtën që në çdo kohë sipas gjykimit të saj të kërkojë nga bankat, respektivisht degët e bankave të huaja, që të zbresin ekspozimet kreditore në limite më të ulëta.

## **Neni 6**

### **Mbikëqyrja nga bordi i drejtorëve**

1. Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se banka plotësisht i kupton obligimet ligjore lidhur me kufizimet mbi ekspozimet dhe koncentrimet e rreziqeve, sipas nenit 46 të Ligjit për banka.
2. Bordi duhet të sigurojë se banka ka politika për kontrollin e ekspozimeve të mëdha dhe koncentrimin të rrezikut. Politika dhe ndryshimet në të, duhet të rishikohen dhe aprovohen nga ana e bordit.

3. Bordi duhet të jetë përgjegjës për të siguruar se banka ka procedura dhe sisteme adekuate për identifikimin, matjen dhe kontrollin e ekspozimeve të mëdha dhe koncentrimin të rrezikut, si dhe të monitorojë pajtueshmërinë me politikën e aprovuar.

4. Bordi duhet të pranojë raporte të rregullta, me qëllim të lehtësimit të rishikimit të ekspozimeve të mëdha dhe koncentrimin të rrezikut në bankë.

#### **Neni 7**

#### **Raportimi rregullator**

1. Bankave u kërkohet të raportojnë në BQK ekspozimet e tyre të mëdha në formën e raportimit të ekspozimeve të mëdha.

2. Nëse është e nevojshme, BQK-ja mund të kërkojë nga një bankë e veçantë kërkesa shtesë raportuese lidhur me ekspozimet e mëdha.

3. Banka duhet të njoftojë menjëherë BQK-në për çfarëdo shkelje të kufizimeve ligjore, të nenit 46 të Ligjit për banka, të kësaj Rregulloreje apo kufizimeve të tjera të caktuara nga BQK-ja.

#### **Neni 8**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

1. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

2. Nëse një shkelje ndodh, BQK-ja mund të ndërmarrë veprime të tjera adekuate, si p.sh rritjen e raportit të adekuatshmërisë së kapitalit për bankën apo kufizimin e zgjerimit të aktivitetit. Gjithashtu mund të kërkojë nga banka të pajtohet për një orar për të sjellë shpejt ekspozimin nën kufizimet ligjore apo çfarëdo kufizimi të pajtuar dhe të raportojë për progresin e arritur rregullisht.

#### **Neni 9**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja për ekspozimet e mëdha, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 10 maj 2013 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

#### **Neni 10**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës